



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE DIVJAKE

Nr. 5124/ Prot. 38

Divjakë, më 28/12/2021

VENDIM

Nr. 70, datë 28/12/2021

“Mbi miratimin e Kalendarit orientues per menaxhimin e shpenzimeve vendore 2023 – 2025”

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 139/2015 , date 17.12.2015 “ *Per Veteqeverisjen Vendore* ”, si dhe te ligjit numer 68/2017, date 27.04.2017, “Per financat e veteqeverisjes vendore, neni 33, Kalendar i programit Buxhetor Afatmesem I buxhetit vjetor, pika 2, Kalendar miratohet nga Keshilli I Njesise se qeverisjes vendore jo me vone se data 31 dhjetor dhe hyn ne fuqi ne daten e pare te cdo viti buxhetor, Keshilli i Bashkise Divjake, me date 28/12/2021:

VENDOSI:

- 1- Te miratoje Kalendarin per Programin Buxhetor Afatmesem 2023 – 2025.
- 2- Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e buxhetit dhe Finances, Drejtoria e taksave dhe te ardhruave vendore, Drejtoria e pal; nifikimit dhe zhvillimit urban, Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike, Sektori i rrugeve rurale, Drejtoria e Bujqesise, Sektori Ujitjes dhe Kullimit, Sektori i Pyjeve, Sektori i burimeve njerzore, T dhe protokoll arxhiva, Sektori MNZH, Sektori i arsimit parauniversitar dhe te mesem, Agjencia e Sherbimit Komunal, Njesite Administrative Terbuf, Gradishte, Grabjan, Remas.
- 3- Ky vendim hyne ne fuqi sipas nenit 54/d,e ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015,”Per Veteqeverisjen Vendore”.
- 4- Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI

I

KESHILLIT TE BASHKISE DIVJAKE

Ana NAKO



KALENDARI ORJENTUES PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE VENDORE 2023-2025

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Dhjetor	Brenda muajt dhjetor	Kryetari i NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Dhjetor	Deri - 31 Dhjetor	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Janar	15	Kryetari i NJQV-së	Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese
Janar	31	Kryetari i NJQV-së	Kryetari i njësisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
Mars	1	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
Mars	Brenda dates 15	Kryetari i NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA
Mars	15	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
Mars	20	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësise vendore dhe e shpërndan tek njësitet shpenzuese
Mars - Prill	21 Mars - 25 Prill	Njësitet shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Mars - Prill	26 Prill - 27 Prill	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2023-2025
Mars - Prill	28 Prill - 30 Prill	Njësitet shpenzuese të Bashkisë	Njësitet shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura
Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	16 Maj - 26 Maj	Kryetari i NJQV-së	Organizon seancat dëgjimore me Banorët
Maj	27 Maj - 29 Maj	Kryetari i NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2023-2025 me shoqërinë civile
Maj	30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Perpilon draftin e fazes së parë të PBA-së 2023-2025
Qershor	1	Kryetari i NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave	Dërgon kështu një raport me mendime mbi projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 25	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave
Qershor	Deri - 30	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	25	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese
Korrik - Gusht	26 Korrik-31 Gusht	Njësitet shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	1	Njësitet shpenzuese të bashkisë	Njësitet shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat buxhetore të rishikuara
Shtator	2 Shtator - 14 Shtator	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	Deri - 15	Kryetari i NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar
Shtator-Tetor	Deri 5 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njësitet e vetëqeverisjes vendore
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të
Tetor-Nentor	6 Tetor - 30 Nentor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2023 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2023-2025 dhe i paraqet për shqyrtim në Këshill.
Dhjetor	25	Këshilli i njësisë vendore	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor
Dhjetor	31	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

Ana NAKO

